



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS PËR VITIN 2025

Prishtinë, maj 2026

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Këshillit Gjyqësor të Kosovës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

A1 Vonesa në pagesë të faturave nga 33 ditë deri 194 ditë, pas afatit ligjor të lejuar për pagesë.  
*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Drejtori i Sekretariatit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Sekretariatit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesuesi i KGjK-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

**Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e shpenzimeve, pasurisë, obligimeve të papaguar dhe detyrimeve kontingjente.

Ky raport ka rezultuar me pesë rekomandime, katër rekomandime të reja dhe një rekomandim i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Mosrespektimi i afateve për pagesën e obligimeve

**Gjetja** Sipas Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin financave publike përkatësisht Nenit 39.1 përcakton se ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Në pesë raste kemi identifikuar se, faturat në vlerë totale prej 101,325€ nuk janë paguar brenda afatit ligjor prej 30 ditëve. Vonesa në pagesë të katër faturave është nga 33 ditë deri 194 ditë, pas afatit të lejuar për pagesë, ndërsa një faturë nuk është paguar ende. Për më tepër, vlera prej 2,258€ nuk u raportua si obligim në pasqyrat financiare, që rrodhi nga një faturë totale prej 10,070€, e që ishte paguar pjesërisht 7,812€.

Kjo ka ndodh si pasojë e mungesës së mjeteve financiare për mbulimin e obligimeve, ndërsa dobësitë në evidentimin e plotë të obligimeve janë pasoje e mos funksionimit të kontrolleve.

**Ndikimi** Mungesa e mjeteve financiare dhe dobësitë në evidentimin e plotë të obligimeve kanë çuar në akumulimin e borxheve dhe mosprezantimin e tyre në pasqyrat financiare. Si pasojë, kjo rrit rrezikun për menaxhim joefektiv të detyrimeve, përmes bartjes së tyre në vitin vijues dhe e ekspozon KGJK-në ndaj padive nga furnitorët, duke gjeneruar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbartimore.

**Rekomandimi A1** Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë se bëhet planifikimi adekuat buxhetor, evidentim i plotë dhe me kohë i obligimeve, si dhe monitorim efektiv të tyre, në mënyrë që të shmangët akumulimi i borxheve, bartja e tyre në vitet pasuese dhe ekspozimi ndaj kostove shtesë gjyqësore dhe përmbartimore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategoritë ekonomike: investimet kapitale, mallrat dhe shërbimet, si dhe obligime të papaguara.

#### Çështja A2 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

##### Gjetja

Sipas Rregullores Financiare nr.01/2013 për shpenzimin e parasë publike, nenit 18 përkatësisht paragrafit 3, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Gjithashtu, sipas Udhëzim Administrativ Nr. 19/2009 për Planin Kontabël, neni 11 të gjithë Zyrtarët Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtarët Kryesor financiar të organizatave (ZKF) buxhetore duhet të sigurojnë që të gjitha transaksionet të regjistrohen në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve caktuara në këtë Udhëzim Administrativ.

Gjatë vitit 2025, Thesari bazuar në vendimet gjyqësore kishte kryer pagesa në vlerë total prej 291,133€ nga kategoritë ekonomike joadekuate.

Nga investimet kapitale janë kryer pesë (5) pagesa në vlerë totale 243,001€ dhe katër (4) pagesa nga mallrat dhe shërbimet në vlerë totale 28,848€, të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe transfereve, pasi lidhen me kompensimin e dëmit ndaj personave të dënuar apo të arrestuar pa bazë ligjore.

Po ashtu, nga kategoria mallra dhe shërbime janë kryer katër (4) pagesa në vlerë totale 19,284€, që për nga natyra i përkasin kategorisë paga dhe mëditje.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së buxhetit të mjaftueshëm për mbulimin e obligimeve në kategoritë përkatëse, përkundër kërkesave të vazhdueshme të KGJK-së për buxhet shtesë me qëllim të mbulimit të këtyre shpenzimeve.

##### Ndikimi

Kjo ka ndikuar në shpenzimin e parregullt të buxhetit dhe në prezantimin e gabuar të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike, raportimin e pasaktë financiar, si dhe në uljen e besueshmërisë së Pasqyrave Financiare Vjetore.

##### Rekomandimi A2

Kryesuesi i KGJK të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për planifikimin e shpenzimeve në ndarje adekuate buxhetore, duke siguruar që realizimi i pagesave të bëhet në kategoritë përkatëse ekonomike, me qëllim të raportimit të saktë dhe të drejtë në PFV.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja B1 - Mangësi në menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së operatorëve ekonomikë,****Gjetja**

Bazuar në rregulloren Nr.001/2022 për Prokurimin Publik sipas nenit 70.2 Vlerësimi i performancës së kontraktuesve - i referohet vlerësimit të performancës së kontraktuesve gjatë dhe me përfundim të implementimit të kontratave publike dhe kontratave kornizë. Vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet: i) në sistem të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, dhe iii) në pajtim me manualin për përdorim të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve. Po ashtu edhe neni 73.1 Autoritetet kontraktuese nëpërmjet menaxhereve të kontratës dhe sistemit të prokurimit elektronik do të mirëmbajnë një përmbledhje të shënimeve të menaxhimit të kontratës lidhur me çdo procedurë prokurimi (a-f).

Në gjashtë raste menaxherët e kontratave, në raportin e monitorimit të kontratave, nuk kanë evidentuar dorëzimet, pagesat/faturat, arsyet e shtyrjes së afatit të kontratave apo çfarëdo aktiviteti që lidhet me implementimin e kontratës. Gjithashtu, menaxherët e kontratave nuk kanë bërë vlerësimin e performancës së operatorëve ekonomikë/kontraktorëve gjatë dhe pas përfundimit të implementimit të kontratës.

Mbingarkesa e menaxherëve të kontratave, si rezultat i menaxhimit të njëkohshëm të disa kontratave, ka ndikuar në moszbatimin e plotë të kërkesave për monitorim dhe vlerësim të performancës së kontraktuesve.

**Ndikimi**

Mungesa e dokumentimit të plotë dhe mosvlerësimi i performancës së kontraktuesve zvogëlon transparencën dhe llogaridhënien në menaxhimin e kontratave, si dhe rrit rrezikun për mosrealizim të plotë të kontratave sipas kushteve të përcaktuara.

**Rekomandimi B1**

Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë se menaxheret e kontratave përgatitin raportin për monitorim të implementimit të kontratave duke evidentuar informatat relevante mbi progresin kohor, dinamikën e pranimeve dhe pagesave. Po ashtu të sigurojë vlerësimin e performancës së operatorëve ekonomik/kontraktuesve gjatë dhe me përfundim të implementimit të kontratave publike dhe kontratave kornizë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Pasuria kapitale neto e prezantuar në pasqyrat financiare është 28,367,471€, ndërsa ajo jo kapitale është 1,903,320€. Menaxhimi i regjistrave të pasurisë mbetet sfidë për KGJK-në, si në vijim:

### Çështja A3 - Mos barazimi i regjistrave të pasurisë me raporte të inventarizimit

**Gjetja** Sipas rregullores nr. 02/2013 - Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat, neni 19, pika 4.7, përcakton hartimi i raportit të përgjithshëm bëhet në bazë të raporteve individuale të komisionit për inventarizimin e pasurisë jo financiare në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Po ashtu neni 24 kërkon pas barazimit të gjendjes me inventarizim dhe vlerësim me gjendjen e regjistrave të pasurisë jo financiare, gjendja e pasurisë jo financiare duhet jetë pjesë e pasqyrave vjetore financiare në pajtim me rregullën financiare për pasqyrat vjetore financiare.

Raporti i inventarizimit për pesë njesi (sekretariati dhe katër gjykata), nuk është përfunduar para përgatitjes së pasqyrave financiare. Po ashtu KGJK nuk ka arrit të bëjë barazimin e regjistrave të pasurisë me raportet e njësive tjera të inventarizimit, të cilat kanë përfunduar me kohë. Si rrjedhojë, vlerat e prezantuara të pasurisë në pasqyrat financiare nuk mund të konfirmohen si të sakta.

Kjo ka ndodhë nga mungesa e përgjegjësisë së zyrtarëve dhe mbikëqyrjes të pamjaftueshme nga ana e menaxhmentit për të siguruar që inventarizimi dhe barazimi i regjistrave, të kryhen me kohë dhe saktësi.

**Ndikimi** Mungesa e barazimit të të dhënave dhe vonesat e përfundimit të procesit të inventarizimit, ndikon në mbivlerësim ose nënvlerësim të pasurive jo financiare dhe dëshmon për kontrole të dobëta të brendshme në menaxhimin e aseteve.

**Rekomandimi A3** Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë që të krijohet një mekanizëm efektiv kontrolli që zyrtarët e pasurisë të bëjnë barazimin e regjistrave kontabël me raportet e inventarizimit menjëherë pas përfundimit të procesit, duke korrigjuar çdo mospërputhje para përgatitjes së pasqyrave financiare. Po ashtu, të kërkohet përgjegjësi nga komisionet, që proceset e inventarizimit dhe raportimit të përfundohen me kohë.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.2.3 Detyrimet kontigjente

Detyrime kontigjente të prezantuar në pasqyra financiare në fund të vitit është 32,367,064€ që në raport e vitin e kaluar janë zvogëluar për 63%, për shkak të përfundimit të proceseve gjyqësore dhe zvogëlimit të vlerave në favor të KGjK-së. Megjithatë ne kemi identifikuar mangësitë në vijim:

#### Çështja A4 - Nënvlërësimi i detyrimeve kontigjente

**Gjetja** Sipas rregullores së MF - nr. 01/2017 Për raportim vjetor financiar, neni 18, parasheh që organizatat buxhetore në harmoni LMFPP-në, raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente.

Në tri raste KGjK, ka prezantuar pjesërisht detyrimet që dalin nga paditë, që ka rezultuar në nënvlërësimin të detyrimeve kontigjente në vlerë prej 59,211€.

Kjo kishte ndodhur në mungesë të kontrolleve dhe pakujdesisë së zyrtarëve përgjegjës.

**Ndikimi** Nënvlërësimi i detyrimeve kontigjente ndikon në prezantimin e pa saktë të kësaj llogarie në pasqyra financiare.

**Rekomandimi A4** Kryesuesi i KGjK-së duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin e pëotë të detyrimeve kontigjente, në mënyrë që të mundësohet prezantim i saktë i detyrimeve kontigjente dhe raportim i drejtë në PFV.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>36,062,871</b>	<b>37,983,910</b>	<b>36,979,253</b>	<b>34,403,320</b>	<b>30,781,798</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	35,562,871	37,166,877	36,269,818	32,616,844	29,930,965
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,766	0	1,067,220	0
Të hyrat vetanake	500,000	500,000	498,954	498,234	594,026
Donacionet e jashtme	0	315,267	210,480	221,023	256,806

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 1,921,039€. Ky ndryshim është rezultat i rritjes së buxhetit me vendim të qeverisë për 2,191,109€, nga bartja e të hyrave vetanake për 149,663€ dhe rritjes me donacione për 315,267€, pastaj zvogëlimit për kursimet buxhetore në fund të vitit për 735,000€.

Në vitin 2025, KGjK ka shpenzuar 97% të buxhetit përfundimtar ose 36,979,253€, që është 2% më lartë se realizimi i vitit 2024, që ishte 95%.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>36,062,871</b>	<b>37,983,910</b>	<b>36,979,253</b>	<b>34,403,320</b>	<b>30,781,798</b>
Pagat dhe mëditjet	26,099,871	28,237,640	28,195,371	25,259,566	23,561,547
Mallrat dhe shërbimet	5,193,000	5,561,607	5,331,980	5,615,606	5,092,450
Komunalitë	650,000	555,000	430,905	348,770	325,475
Subvencionet dhe transferet	500,000	649,663	646,851	842,375	497,006
Investimet Kapitale	3,620,000	2,980,000	2,374,146	2,337,004	1,305,320

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Tek pagat dhe mëditjet, buxheti final është rritur për 2,137,769€. Ky rritje është rezultat i vendimeve të qeverisë nr. 03/261, të datës 05.06.2025 dhe nr. 02/282, të datës 26.12.2025 për 1,903,970€, si dhe përfitimit të grandit nga donatorët për 233,799€. Realizimi në këtë kategori është 28,195,371€ apo 99.9%.
- Tek mallrat dhe shërbimet, buxheti final në raport me buxhetin fillestar është rritur për 368,607€. Kjo rritje është rezultat i transferimit të mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale me kërkesë të KGJK-së për 390,000€, nga grandet e donatorëve për 81,468€ dhe zvogëlimit me vendimit të qeverisë nr. 04/282 të datës 26.12.2026 për 102,861. Realizimi është 5,331,980€ apo 96%.
- Tek komunalit, buxheti fillestar në raport me atë final është zvogëluar për 95,000€. Ky ndryshim është rezultat i vendimit të qeverisë nr. 04/282, të datës 26.12.2026. Realizimi është 430,905€ apo rreth 78%.
- Tek subvencionet dhe transferet, buxheti final është rritur për 149,663€. Kjo rritje është rezultat i transferit të mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale në vlerë 150,000€ me kërkesë të KGJK-së, nga të hyrat e bartura për 1,766€ dhe zvogëlimit me vendimit të qeverisë nr. 04/282 të datës 26.12.2025. Realizimi është 646,851€ apo rreth 99.5%.
- Tek investimet kapitale buxheti final është zvogëluar për 640,000€. Zvogëlimi për 540,000€ është nga bartja e mjeteve në kategorinë mallra dhe shërbime për 390,000€ dhe subvencione dhe transfere për 150,000€, po ashtu me vendimit të qeverisë nr.04/828, të datës 26.12.2025, për 100,000€. Realizimi është 2,374,146€ apo 80%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në 2025 ishin në vlerë 11,682,886€. Ato kanë të bëjnë me gjobat e trafikut, gjobat nga gjykatat, taksat gjyqësore, të hyrat nga lëshimi i licencave për shërbime profesionale, gjobat dhe taksat nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme. Krahasuar më vitin paraprak kemi rritje të të hyrave për 876,423€ apo 8%. Kjo rritje kryesisht ka të bëjë me rritjen e të hyrave nga taksat gjyqësore, pasi që gjatë vitit 2025 kanë ndryshuar tarifatat me rregullore të re.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>12,571,605</b>	<b>12,571,605</b>	<b>11,682,886</b>	<b>10,806,463</b>	<b>10,191,248</b>
Të hyrat jo tatimore	12,571,605	12,571,605	11,682,886	10,806,463	10,191,248

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2024 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka rezultuar me katër rekomandime. KGjK kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, tri rekomandime janë zbatuar, ndërsa një rekomandim nuk është zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak





Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryesuesi i KGJK-së duhet të forcoj kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive dhe të siguroj që pasuritë evidentohen në regjistra përkatës sipas legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të mundësohet regjistër i plotë i pasurisë dhe raportim i drejtë në PFV.	KGJK ka ndërmarr veprimet që të gjitha pasuritë të regjistrohen sipas ligjit në fuqi.	I zbatuar
2.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari i KGJK-së duhet të forcoj kontrollet në menaxhimin e burimeve njerëzore duke përgatitur dhe ofruar zyrtarëve aktual për nënshkrim aktet e reja të emërimit apo kontratat e punës në mënyrë që çdo pagesë të realizohet bazuar në akt emërim/kontratë individuale dhe me koeficient aktual sipas legjislacionit në fuqi. Po ashtu duhet të sigurohet që çdo pagesë e retroaktive të paguhet vetëm kur përcjellët me dëshmi përkatëse.	Janë ndërmarr veprimet për azhurnimin e akt emrimeve/kontratave sipas rregullorës në fuqi. Po ashtu KGJK ka ndërmarr veprime, që të gjitha pagesat retroaktive apo shtesat të llogariten siç duhet.	I zbatuar
3.	Çështjet e përbashkëta	Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë se menaxheret e kontratave përgatitin raportin për monitorim të implementimit të kontratave duke evidentuar informatat relevante mbi progresin kohor, dinamikën e pranimeve dhe pagesave. Po ashtu të sigurojë vlerësimin e performancës së operatorëve ekonomik/kontraktuesëve gjatë dhe me përfundim të implementimit të kontratave publike dhe kontratave kornizë.	KGJK ka kërkuar nga të gjithë menaxherët e kontratave që menaxhimin e kontratave të bëjnë përmes modulit të e-prokurimit, mirëpo ende nuk është arrit që të gjitha kontrata të menaxhohen përmes e-prokurimit.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Pasuritë	Kryesuesi i KGJK-së duhet të siguroj vënien në funksion të sistemit e-pasuria për menaxhimin e materialit shpenzues/stoqeve me qëllim të ruajtjes nga keqpërdorimet e mundshme të pasurisë dhe raportimin e drejtë të saj në PFV.	KGJK ka filluar të përdorë sistemi e-pasuria për menaxhimin e stoqeve.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Qëndresa Isufi, Udhëheqëse e ekipit



Luljeta Morina, Anëtare e ekipit



Shemsije Llugiqi, Anëtare e ekipit



# Shtojca I: Letër konfirmimi

## Letërkonfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE/PRATHMËSHËRËSIAR: DATUM/PRITHËMËSHËRËSIAR:		26-05-2026	
Njsia Org. Org. Jedim. Org. Unit.	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr.faqeve Br. Stranica No. Pages
05	47	846	1



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
 REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
 SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

**LETËR E KONFIRMIMIT**

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejme “Raporti”);
- pajtohem/ nuk pajtohem/ pajtohem pjesërisht/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z.Rrustem Thaqi

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Data: 25 Maj 2026, Prishtinë




## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.